

03
Right of EST & freedom
to provide services

KAPITULLI 3

E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime

Liria për të ofruar shërbime është një nga katër liritë themelore të BE-së. Së bashku me të drejtën për t'u vendosur, ajo garanton lëvizshmërinë e bizneseve dhe profesionistëve brenda BE-së.

E drejta e vendosjes nënkupton të drejtën për të filluar dhe zhvilluar një aktivitet ekonomik nga një vendndodhje fizike (zyrë, dyqan, fabrikë, fermë, etj) në një vend tjetër. Këtë të drejtë e gëzojnë si personat fizikë shtetas të një vendi anëtar (të vetëpunësuarit) ashtu edhe personat juridikë (firmat) e regjistruara në një vend anëtar.

Ndërsa liria për të ofruar shërbime u jep të drejtën qytetarëve (profesionistë të lirë apo persona fizikë) dhe firmave të regjistruara në një vend anëtar të ofrojnë shërbime pa asnjë kufizim në çdo vend tjetër të BE-së, pa patur nevojë të regjistrohen (si person fizik apo juridik) në atë vend.

Pra, ushtrimi i këtyre dy lirive u jep të drejtën personave të vetëpunësuar dhe firmave:

1. të realizojnë një aktivitet ekonomik në mënyrë të qëndrueshme dhe vazhdueshme në çdo vend tjetër të BE-së duke u vendosur në të.
2. të ofrojnë dhe sigurojnë shërbime në një vend tjetër anëtar në mënyrë të përkohshme ndërkohë që mbeten në vendin e origjinës—pra, të ofrojnë shërbime ndërkufitare.

Për të garantuar këto liri, Shqipëria duhet:

- të përshtasë legjislacionin për të lejuar vendosjen dhe ofrimin pa pengesë të shërbimeve në Shqipëri nga qytetarët dhe firmat e BE-së dhe për të lehtësuar dhe thjeshtësuar procedurat e bërjes biznes, përfshi regjistrimin, marrjen e lejeve, licencave etj;

- të harmonizojë rregullat që sigurojnë njohjen reciproke të kualifikimeve dhe diplomave të vendeve anëtare dhe Shqipërisë në fushën e profesioneve të rregulluara; për disa profesione të rregulluara të vendosë standardet minimale të formimit të nevojshme për njohjen automatike të kualifikimeve;

- të hapë sektorin e shërbimeve postare ndaj konkurrencës dhe në mënyrë graduale të garantojë liberalizimin e tij duke siguruar ndërkohë një shërbim universal postar.

Anëtarësimi në BE do u mundësojë firmave shqiptare qasje në tregun e jashtëzakonshëm të shërbimeve të BE-së, i cili përbën rreth dy të tretat e ekonomisë së BE-së.

Profesionistët e lirë shqiptarë (mjekë, dentistë, arkitektë, inxhinjerë, financierë, juristë, etj.) do të kenë gjithashtu mundësinë të ofrojnë shërbime në çdo vend të BE-së me të njejtat kualifikime (certifikime) që kanë në Shqipëri. Ata do mund t'i ofrojnë shërbimet e tyre nga Shqipëria pa patur nevojë të jenë banorë apo të pranishëm në vendin përkatës të BE-së.

Lëvizja e lirë e kapitalit garanton lëvizjen pa pengesa të kapitalit mes vendeve anëtare të BE-së, si dhe me vendet e treta. E fundit nga katër liritë themelore të Bashkimit Europian, ajo është më e gjëra pasi e shtrin veprimin e saj edhe ndaj vendeve joanëtare. Ajo plotëson tre liritë e tjera (të mallrave, shërbimeve dhe njerëzve) për të siguruar funksionimin e tregut të përbashkët, nxit përdorimin e Euros si monedhë e rëndësishme ndërkombëtare dhe kontribuon në rritjen ekonomike duke mundësuar përdorimin efikas të kapitalit fizik dhe financiar.

Grupet me interes për t'u përfshirë:

- Shoqatat e profesioneve të lira; shoqatat e operatorëve në sektorë të caktuar, siç shoqatat bankare dhe financiare; shoqatat e biznesit; dhomat e tregtisë dhe industrisë.

Institucioni ndihëbeqës i negociatave:

- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Institucione kyçe të përfshira në negociatë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
- Qendra Kombëtare e Biznesit